



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI**

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Tiranë, më 5.6.2019

**RAPORT
PËR PROJEKTLIGJIN**

“PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË HUAS, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË (HUAMARRËSI), OPERATORIT TË SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE (OSHEE), SH.A., (AGJENCIA ZBATUESE E PROJEKTIT) DHE KFW, FRANKFURT AM MAIN (KFW), PËR PROGRAMIN E INVESTIMEVE PËR SHPËRNDARJEN E ENERGJISË ELEKTRIKE I”

- HYRJE

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, në mbledhjen e datës 5 qershor 2019, mori në shqyrtim projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (huamarrësi), Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE), sh.a., (agjencia zbatuese e projektit) dhe KFW, Frankfurt am main (KFW), për programin e investimeve për shpërndarjen e energjisë elektrike I”.

Komisioni caktoi si relator për shqyrtimin e këtij projektligji deputetin Adnor Shameti. Komisioni e shqyrtoi projektligjin në zbatim të neneve 32-38 të Rregullores së Kuvendit.

Për të paraqitur projektligjin, në mbledhjen e Komisionit ishin të pranishëm përfaqësues të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

- BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJIT

Projektligji, nismë e Këshillit të Ministrave, është bazuar në nenet 81, pika 1, dhe 121 të Kushtetutës, si dhe në nenin 17 të ligjit nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, sipas të cilit:

“Neni 17

Ratifikimi

1. Ratifikimi është akti, me anë të të cilit Republika e Shqipërisë shpreh pëlqimin për të qenë e lidhur nga një marrëveshje ndërkombëtare e nënshkruar më parë prej saj...”

- QËLLIMI DHE PËRMBAJTJA E PROJEKTLIGJIT

Projektligji synon ratifikimin e marrëveshjes që do t’i mundësojë Republikës së Shqipërisë marrjen e një huaje prej 30 000 000 (tridhjetë milionë) eurosh, me kushte të favorshme nga qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë, nëpërmjet KfW-së, për projektin “Për programin e investimeve në shpërndarjen e energjisë elektrike I”.

Programi do të ndikojë në përmirësimin e rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike, reduktimin e humbjeve të energjisë elektrike në rrjetin e shpërndarjes, si dhe rritjen e cilësisë dhe të sigurisë së furnizimit me energji elektrike për klientët në Shqipëri.

Me fondet e akorduara do të realizohen komponentët e mëposhtëm:

- Komponenti i parë do të realizojë dhe do të krijojë një sistem kontrolli mbikëqyrës dhe të përpunimit të të dhënave (SCADA), do të krijojë një sistem menaxhimi të shpërndarjes (DMS), sistem të shpërndarjes së ngarkesës (LDS), një qendër të kontrollit të shpërndarjes (DCC), dhe sisteme të tjera të integruara të teknologjisë së informacionit (IT).
- Komponenti i dytë do të përfshijë rehabilitimin dhe/ose ndërtimin e nënstacioneve të përzgjedhura 110 kV/20 kV, duke përfshirë kapacitetin e transmetimit në 2x40 MVA në nënstacionet e mbingarkuara, si dhe zgjerimin e voltazhit të mesëm të nënstacioneve ekzistuese.
- Komponenti i tretë do të përfshijë përshtatjen e rrjetit me voltazh të mesëm në nivelin 20 kV në zonat e përzgjedhura.

- Propozim për rregullim të teknikës legislative

Në titullin dhe në tekstin e projektligjit të hiqen si të panevojshme shkurtime ("Huamarrësi"), ("Agjencia Zbatuese e Projektit"), (OSHEE), (KfW), pasi këto shkurtime jepen në tekstin e Marrëveshjes, bashkëlidhur projektligjit.

Në përfundim, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, pasi vlerësoi se:

-Në aspektin ligjor projektligji është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi;

-Në aspektin procedural, projektligji është paraqitur në përputhje me Kushtetutën dhe Rregulloren e Kuvendit;

dhe pasi e shqyrtoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi, e miratoi atë me votat e shumicës së anëtarëve të pranishëm, dhe vendosi t'ia kalojë për miratim seancës plenare.

RELATOR

Adnor SHAMETI

KRYETARI

Ulsi MANJA